

Arta Berisha*

Përdorimi i shërbimeve online të informimit nga televizionet rajonale në Kosovë

Abstrakt

Përdorimi i rrjeteve sociale nga ana e televizioneve rajonale në Kosovë për informimin e publikut që ndodhet përtej rajoneve që u përkasin, është tema e këtij punimi. Ndonëse në kuptimin klasik të fjalës, media lokale dhe rajonale përfshinë interesin e lokalitetit dhe rajonit që mbulon, në ditët e zhvillimeve të shpejta teknologjike, kjo duket se nuk ka kuptim. Mediat lokale të licencuara pranë Komisionit të Pavarura për Media, emetojnë program nëpërmjet rrjeteve kabllore duke mbuluar kështu hapësirë të gjerë të territorit po aq sa mediat nacionale të cilat emetojnë edhe nëpërmjet rrjetit tokësor. Zhvillimi i mediave lokale në përputhje me mundësitë online të informimit është një proces tjetër, por që zhvillohet me hapa më të ngadalshëm. Në këtë punim analizohet përmbajtja e lajmeve të postuara në llogaritë e tri televizioneve rajonale në facebook si platformë më popullore në Kosovë. Televizionet rajonale për të cilat bëhet analiza janë; TV Prizreni dhe TV Opinion që mbulojnë rajonin e Prizrenit si dhe TV Tema në Ferizaj. Nga metoda kualitative e hulumtimit rezulton se lajmet që prekin interesat e banorëve lokalë dhe lajmet që për subjekt kanë aktivitetet e komunave përkatëse përbëjnë kryefjalën e përmbajtjes. Por hapësirë gjejnë edhe lajmet që kanë si burim informacioni të drejtpërdrejtë, drejtuesit e institucioneve qendrore. Nga intervistat me drejtues të televizioneve, kuptohet se mediat lokale nuk u kushtojnë shumë vëmendje shërbimeve online të informimit. Kjo ndodhë për disa arsye, në plan të parë, vështirësitë financiare me të cilat ballafaqohen, më pastaj edhe mungesa e burimeve njerëzore.

Fjalë kyç: Rrjetet sociale, facebook, media lokale - rajonale, televizioni.

* MA. Arta Berisha, Fakulteti i Komunikimit Masiv, Kolegji AAB, Prishtinë. E-mail: berishaarte@gmail.com

1. Funksionimi i mediave lokale dhe rajonale në Kosovë

Komisioni i Pavarur për Media është institucioni që rregullon, menaxhon dhe mbikëqyrë spektrin e frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. Në bazë të ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, ky institucion licencën transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale, audio dhe audivizuale.¹ Detyrë dhe përgjegjësi e KPM-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audiovizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare.² Gjithsej 93 është numri i shërbimeve audio dhe audivizuale lokale dhe rajonale të licencuara pranë KPM-së. Mediat lokale dhe rajonale janë të licencuara në Kosovë duke fituar nga një frekuencë analoge për transmetim tokësor. Në bazë të termave të referencës së licencës ato janë të detyruara t'i respektojnë kriteret programore teknike. Kriteret programore kanë të bëjnë me përmbajtjen që plasohet e cila duhet të jetë në interes së zonës së mbulueshmërisë. Gjeografikisht ato janë të shtrira në tërë territorin e Kosovës me koncentrim më të madh në Prishtinë.³ Zhvillimi i shpejt i teknologjise dhe hyrja e platformave kabllore ka bërë që të mos ketë kufizime në mbulueshmërinë territoriale. Kështu të gjitha shërbimet audivizuale që kanë mundësinë e transmetimit përmes rrjeteve kabllore mbulojnë pjesën e madhe të territorit po aq sa edhe mediat nacionale. Rrjedhimisht përfshirja gjeografike dhe numri i banorëve në një zonë, po bëhen më pak të rëndësishme, pasi e tëra po zëvendësohet nga

¹ —PëKPM-në,” <http://kpm-ks.org/?faqe=90&gjuha=1>

² Kuvendi i Kosovës, *Ligji për Komisionin e Pavarur për Media*, Nr. 04/L-44, 25 Nëntor 2016, Neni 5.

³ Adnan Merovci, *email autores*, 22 Nentor, 2016

përmbajtja programore. Në ditët e sotme, një media nuk mund të konsiderohet thjesht lokale apo rajonale nëse në një periudhë kohore ka mbuluar në rrjetin tokësor vetëm një rajon, por nëse ajo ka përmbajtje gjithëpërfshirëse atëherë edhe koncepti për të ndryshon. Dhe kjo e tëra falë teknologjive të reja që shpesh herë janë shumë hapa para rregullimeve ligjore.

Zhvillimet teknoko-teknologjike kanë ndikim esencial edhe në kategorizimin e medieve. Çdoherë ky zhvillim është një hap para rregullimit legal (juridik) të tyre. P.sh kohëve të fundit transmetimi përmes internetit ka relativizuar dhe ka thyer barrierat e kategorizimit të mediave. Kjo ka shkaktuar probleme globale në rregullimin e tyre. Portalet e ndryshme, mediat online, IPTV, etj sot nuk janë mirëfillësisht nën pullazin e rregullatorëve të mediave.⁴

2. TV Opinion, TV Prizreni dhe RTV Tema

Kriza politike dhe ekonomike në Kosovë ka pasur ndikim negativ në zhvillimin e mediave lokale dhe rajonale, në përputhje me mundësitë teknologjike që ofrohen në ditët e sotme. Me vetëm 12 punonjës sa ka aktualisht, TV Prizreni, i cili mbulon Prizrenin dhe rrafshin e Dukagjinit, e ka të pamundur t'i shfrytëzoj mediat online për ta informuar publikun, edhe kur bëhet fjalë vetëm për rrjetet sociale. Mungesa e burimeve njerëzore që do të punonin në realizimin e këtij qëllimi është problemi thelbësor me të cilin ballafaqohet ky medium. Në vitin 1999 kur për herë të parë nisi transmetimin në rrjetin tokësor, TV Prizreni kishte 6 punonjës në dy orë transmetim. Deri në vitin 2005 ky numër u pesëfishua. Ndërsa sot, në vitin 2016, TV Prizreni numëron 12 punonjës, përfshirë gazetarët, stafin teknik dhe stafin e marketingut.⁵

Problemet me të cilat ballafaqohen mediat lokale dhe rajonale shtrihen në disa dimensione. Ato kanë të bëjnë me vështirësitë

⁴ Adnan Merovci, *email autores*, 22 Nentor, 2016

⁵ Nuhi Salihu (gazetar, Tv Prizreni), *email autores*, 5 Dhjetor, 2016

financiare që vijnë si pasojë e gjendjes jo të mirë të bizneseve që do të blinin hapësirën mediatike për qëllime marketingu por edhe me konkurrencën jo lojale që mbizotëron në tregun medial të Kosovës.

Në aspektin institucional, vështirësitë më të mëdha po shkaktohen nga rregullatorët (P.sh nga KPM, në aspektin e mos rregullimit të industrisë së kabllorit dhe vendosjes numerike meritore te kanaleve lokale/rajonale neper platforma, pastaj mos efikasiteti i Agjencisë për Mbrojtjen e Konkurrencës në rregullimin e pluralizmit pronësor në industrinë e medias në Kosovë dhe parandalimin e monopolit, si dhe përkrhja gati zero nga institucionet qendrore përzhvillimin e programeve dhe informacioneve lokale neper media te pavarura (sepse, fatkeqësisht, duket se në Kosovë tashmë janë paraqitur media të varura nga politika/qeveria).⁶

Dy vite më vonë se TV Prizreni, në këtë rajon, në vitin 2001 nisë transmetimin lokal tokësor TV HASI. Nën emërtimin aktual TV Opinion, fillimisht transmetonte program eksperimental dy orësh, për të rritur ngadalë fuqinë transmetuese. TV Opinion sot mbulon 63 për qind të territorit të Kosovës me sinjal emetues në një hapësirë më të madhe të rajonit të Rrafshit të Dukagjinit. Nga një televizion në fillim me pajisje teknike modeste, ngadalë dhe me investime tërësisht vetanake, për një kohë të shkurtër, TV Opinioni arriti në një shkallë të përsosmërisë lakmuese duke pretenduar që të jetë konkurrentë edhe i televizioneve më të mëdha me status kombëtar.⁷

Në vitin 2005 tregut mediatik në Kosovë i shtohet TV Tema me bazë në Ferizaj duke e zgjeruar stafin dhe punën e radios Tema, në lëminë e programit televiziv por me karakter rajonal. E licencuar si transmetues rajonal tokësor në një periudhë 10 vjecare, 2010-2020, TV Tema mbulon Ferizajn, Prishtinën, Fushë Kosovën, Kastriotin, Lipjanin, Shtimen, Vitinë, Kacanikun, e pjesërisht Vushtërrinë dhe Podujevën. Ndërsa përmes rregullës për bartje të detyrueshme, TV

⁶ Nuhi Salihu, *email autores*, 5 Dhjetor, 2016

⁷ —Rrth nesh, Historiku,” e rifreskuar ne vitin 2016, <http://www.tv-opinion.com/PerNe.aspx>

Tema transmetohet edhe në platformat kryesore kabllore/IPTV në Kosovë (IPKO, KUJTESA, Tik, Artmotion) si dhe në shumë rrjete kabllore rajonale dhe lokale, po ashtu edhe në dy platforma IPTV në SHBA.⁸

Krahas angazhimit për të kaluar në transmetim dixhital, ku synimi i Televizionit Tema është të licencohet si operator rajonal dhe të shfrytëzojë të drejtën e konvertimit të licencës analoge në atë dixhitale si ofrues i shërbimeve programore, në vitin 2011 Tv Tema ka ndryshuar strategjinë drejt hyrjes më të mirë tek audiencia përmes mediave sociale.⁹

3. Shfrytëzimi i shërbimeve online të informimit

Gjendja e keqe ekonomike në Kosovë ka pasur efektet e saj negative edhe në media. Problemi më i madh për mediat në Kosovë mbetet qëndrueshmëria e tyre financiare, për shkak se shumica e organizatave të mediave varen nga të hyrat e marketingut. Gazetarët pranojnë se mungesa e kontratave të punës është një nga metodat kryesore të përdorura nga pronarët e mediave për të ushtruar tryzni mbi ta.¹⁰ Situata ndikon në shfrytëzimin e mirëfilltë të shërbimeve online për informimin e opinionin në veçanti te mediat lokale. Statistikat e shteteve me ekonomi të konsoliduar tregojnë se numri i të rinjve që përdorin internetin është dukshëm më i madh se i atyre që i kushtojnë kohë të njëjtë televizionit.

Sipas një studimi rezultatet e te cilit u publikuan në gusht 2008 nga New York Times, 83% e të rinjve nga 10=14 vjeç kalojnë me shume se një ore në internet, ndersa 68 % e tyre e kushtojnë po kaq kohe televizionit. Kështu që transferimi i investimeve publicitare në internet ndjek rrjedhën e vet, në 2009-ten me gjithë krizën ekonomike

⁸ Visar Hoti (drejtor, RTV Tema), *emailautores*, 9 Dhjetor, 2016

⁹ Visar Hoti, *email autores*, 9 Dhjetor, 2016

¹⁰ Petrit Collaku. “*Treguesit e Kosovës për nivelin e sigurisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve*” (punim i prezantuar në kuadër të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës në Prishtinë, me datë 17 Dhjetor, 2016).

dhe rënien e investimeve publicitare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shpenzimet e komunikimeve në internet kanë arritur shumën prej 22.7 miliard dollarësh, çka e vendos internetin në vend të dytë pas shtypit të përditshëm 24.6 miliardë dhe pas televizionit 26.2 miliard dollar. Një rritje e madhe është parashikuar në 2010-tën.¹¹

Një studim tjetër i kohëve të fundit nga *International Center for Media and the Public Agenda* tregon se studentët universitarë nëpër botë i kërkojnë lajmet personale ose globale qofshin – në Facebook, Twitter dhe platforma tjera sociale në rrjet dhe shpesh i përziejnë të dyja llojet në mendjen e tyre. Ndjenja që mbizotëron është se —nuk i kërkojmë lajmet, lajmet na gjejnë neve”. Ndonëse nuk ka ndonjë studim për situatën në Kosovë, mediat tradicionale janë duke bërë planet afatgjate të zhvillimit në përputhje me zhvillimet teknologjike.¹²

Facebooku si rrjet me më shumë përdorues në Kosovë duket edhe pikësynimi i tre televizioneve me mbulueshmëri rajonale, që të arrijnë deri tek audiencia nëpërmjet postimit të lajmeve në faqet e tyre zyrtare. TV Prizreni, TV Opinioni dhe RTV Tema, kanë funksionale edhe webfaqet zyrtare dhe kanalet zyrtar në youtube. Por bazuar në analizën që iu është bërë kanaleve online të informimit, facebooku rezulton të jetë hapësira me koncentrimin më të madh për të qenë më afër publikut. Për ta ilustruar, TV Prizreni ka hapur kanalën në youtube në vitin 2012 dhe ka 767 video të postuara. Përmbajtja e tyre nuk është e karakterit informues.

4. Përmbajtja e informacioneve në facebook

Pothuajse i gjithë informacioni që postohet në rrjetin social facebook nga të tre televizionet me mbulueshmëri rajonale është informacion i konsumuar. Të tre televizionet shfrytëzojnë facebookun për t'i postuar kronikat televizive që një ditë më parë janë transmetuar

¹¹ Francis Balle, *Mediat dhe Shoqëritë*: (Tiranë: Papirus, 2011), 327.

¹² Brenda New York Times Faqja Një dhe e Ardhmja e Gazetarisë, edituar nga David Flokenflik, (Tiranë, Instituti Shqiptar i Medias), 161.

në edicionet e lajmeve qendrore.¹³ Monitorimi 20 ditësh, nga data 1 nëntor deri më datë 20 nëntor 2016, që u është bërë lajmeve në facebook nga Tv Prizreni, Tv Opinioni dhe RTV Tema rezulton se numri më i madh i tyre janë tekste të kronikave të shoqëruara me videot që janë transmetuar në televizion. Nga 46 lajme të postuara gjithsej në faqen zyrtare të TV Prizrenit në facebook në periudhën kohore të monitorimit, vetëm nëntë prej tyre janë lajme të reja të shoqëruara me fotografi nga momenti apo vendi i ngjarjes.¹⁴ Në këto raste burim informacioni janë komunikatat për media të policisë së rajonit të Prizrenit, njoftimet për ndërprerjen e energjisë elektrike për këtë rajon, apo edhe apelime për ndihmë mjekësore. Duke qenë se TV Prizreni dhe TV Opinioni mbulojnë rajonin e Prizrenit dhe një pjesë të Dukagjinit, edhe përmbajtja e lajmeve u kushtohet këtyre lokaliteteve. Lajmet me karakter nacional zënë fare pak hapësirë në faqet zyrtare në facebook të të dy televizioneve. Në periudhën për të cilën është bërë monitorimi, TV Opinioni nga 49 lajme të postuara në facebook 15 prej tyre rezultojnë me karakter nacional.¹⁵ Këto lajme kanë për burim informacioni drejtuesit e institucioneve qendrore, presidentin, krye parlamentarën dhe kryeministrin. Më shumë rëndësi TV Opinion u kushton ngjarjeve që ndodhin në qytetin e Prizrenit dhe zonat që e rrethojnë. Duke iu referuar periudhës së analizës, përmbajtja e temave që trajton Tv Opinion i takon më shumë një gazetarie protokollare, ndjekjes së konferencave, dhe takimeve të ngjashme në disa raste partiake.¹⁶ RTV Tema bën përjashtim nga dy televizionet e tjera, për sa i përket përmbajtjes së informacioneve që

¹³ Monitorimet, 1 Nentor, 20 Nentor, 2016, –Tv Opinion, Tv Prizreni, Tv Tema”.

¹⁴ Monitorimet, 1 Nentor, 20 Nentor, 2016, –Tv Prizreni”.

¹⁵ Monitorimi, 18 Nentor 2016, (Korrupsioni është i pranishëm në shumë fusha në Kosovë dhe se mbetet një problem serioz. Kështu u tha në takimin e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit), TV Opinion

¹⁶ Monitorimi, 15 Nentor, 2016, (Esat Sopi, Kryetari I Nëndegës së AAK-së në lagjen 11 Marsi), Tv Opinion

poston në facebook. Bazuar në periudhën kur është bërë monitorimi, ky televizion u kushton rëndësi temave me karakter nacional, siç janë p.sh miratimi i projektligjit për buxhetin e vitit 2017, projektligjit për ndërmarrjen Trepça, dialogut politik në mes të Kosovës dhe Serbisë etj. Përkthyer në shifra, nga 61 lajme gjithsej të postuara në facebook, 33 prej tyre kanë përmbajtje që gëzojnë interes publik përtej rajonit që ky medium është i licencuar nga Komisioni i Pavarur Për Media. Ajo çfarë e karakterizon përmbajtjen e informacioneve të pasura nga TV Tema është se ato nuk janë prodhim i televizionit por artikuj të huazuar nga mediat e tjera; Gazeta Zëri, www.kallxo.com, Klan Kosova dhe Radio Evropa e Lirë.¹⁷

Përfundime

Shfrytëzimi i mirëfilltë i shërbimeve online të informimit nga mediat lokale dhe rajonale në Kosovë kërkon ende kohë. Kjo për shkak të disa faktorëve, por në radhë të parë pamundësisë financiare për të investuar në këtë drejtim. Sado që mediat online, qofshin ato portale apo rrjete sociale, nuk kanë vënë kufizime në shtrirjen e informacionit përtej rajonit të caktuar, mediat për të cilat është bërë punimi, kufizojnë vetveten duke u koncentruar jo thjesht në përmbajtjen për lokalitetin të cilit i takojnë por edhe duke dhënë informacion të konsumuar siç konsiderohen lajmet e një dite më parë, apo lajmet e transmetuara në një medium tjetër siç është webfaqja e televizionit. Konsiderohet i domosdoshëm edhe investimi në burime njerëzore qoftë për t'i mbajtur portalet dhe llogaritë në rrjetet sociale apo edhe për t'i rifreskuar informacionet duke i postuar ato në kohë reale. Temë me interes për tu hulumtuar në të ardhmen është edhe cilësia e përmbajtjes së informacionit dhe profesionalizmi në mediumet lokale dhe rajonale.

¹⁷ Monitorimi, 19 Nëntor, 2016, (Evropa e Lirë, Murtezaj, qëndrimet e Nikoliqit destabilizuese por për keqardhje), TV Tema

Bibliografia

Balle, Francis. *Mediat dhe Shoqëritë*. Papirus, Tiranë, 2011

Folkenflik, David. *Brenda New York Times Faqja Një dhe e Ardhmja e Gazetarisë*. Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë.

Collaku, Petrit. *Treguesit e Kosovës për nivelin e sigurisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve*. Prishtinë, 2016

Ligji për Komisionin e Pavarur për Media, nr 04/L -44. (vizituar: 27 nëntor 2016)

<http://kpm-ks.org/?faqe=90&gjuha=1>

<http://www.tv-opinion.com/PerNe.aspx>

<http://tvtema.net/category/lajme/>

<https://web.facebook.com/prizreni.tv/?fref=ts>

<https://web.facebook.com/tvopinion/?fref=ts>

<https://web.facebook.com/televizioni.tema/?fref=ts>